



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA /
AGENCY OF GENDER EQUALITY

Raporti i Performances

-	Data:	27 Mars 2025
	AGJENCIA	Agjencia për Barazi Gjinore
	MINISTRIA PËRGJEGJËSE	Zyra e Kryeministrit
	Misioni i Agjencisë	Misioni i Agjencisë për Barazi Gjinore është promovimi, mbrojtja dhe avancimi i pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, në Kosovë. Ajo vepron përmes hartimit, zbatimit, monitorimit të zbatimit të politikave publike të cilat ofrojnë mundësi të barabarta për të kontribuar dhe përfshirur nga zhvillimi ekonomik, rifitjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimit të mirëqenies sociale. Synon që përmes qendrimit gjinor të siguroj perspektivën e barazisë gjinore në legjislacion dhe politika publike, në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga fondet publike, eliminohen pabarazitë, duke u angazhuar që të mbijlin hendekun gjinor në zhvillim, eliminimin e stereotipeve gjinore, dhe avancimin e realizimit të të drejtave në vendimmarrje, dhe siguri dhe qasje në drejtësi si garantues i arritjes së barazisë gjinore.

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA Zyra e Kryeministrit - Ured Premjera - Office of the Prime Minister Agjencia për Baraz Gjinore - Agencija za Polnu Ravnopravnost - Agency for Gender Equality
Nr. Prot. B: Prot. Prot. No.	095 / 2025
Data: Datum: Date:	27/03/2025
	Pristina/Priština/Pristina

Objektivat	Treguesi(t)	Vlera e synuar	Vlera faktike	Rezultatet (Autputet) e planifikuara	Rezultatet (Autputet) e përfunduara (Po/Io)	Shënim shpjegues
Objektivi 1: 1. Avancimi i te drejtave te njeriut ne plotësim te agjendës për mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës ne familje	Përafrimi i kornizës ligjore dhe shërbyemeve me kërkesat e Konventës se Stambollit, bazuar ne obligimet e dalura nga Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen ne Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026			4 trajnime te planifikuara	- Agjencia për Barazi Gjimore në bashkëpunim me Policinë e Kosovës ka mbajtur 5 sesione informues lidhur me Konventën e Stambollit dhe ndryshimet në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjimore me mbikëqyrësit rajonal të hetimeve të dhunës në familje në kuadër të stacioneve policore të drejtorisë rajonale ne këto komuna: <i>Prishtinë, Pejë, Gjiilan, Prizren dhe Ferizajt ne këto sesione trajnuese moren pjesë 106 persona ne total prej tyre 82 burra dhe 24 gra. Buxheti i ABGJ-se 3,091.78 euro</i> - ABGJ- ka themeluar grupin punues për plotësimin dhe ndryshimin e Procedurave Standarde te Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna ne familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna ne baza gjimore. Grupi punës ka mbajtur punëtori 6 dite, është hartuar drafti i parë i cili është ndarë me GP për komente. Buxheti i ABGJ-së 7 206.60 euro. Procesi vazhdon. - Në kuadër te 16 Ditëve të Aktivizimit në Komunën e Istogut ABGJ ka prezantuar korniza ligjore që garanton dhe promovon barazinë gjimore, parandalimin e dhunës në familje dhe dhunën në baza gjimore .	

Numri i fushatave për sensibilizim dhe vetëdijesim	Planifikimi për 2 ndriçime të Ndërtesës së Qeverisë	- Gjate kësaj fushate Agjencia për Barazi Gjimore ka ofruar trajnim edhe për Shokatën e grave të shërbimit Korrektues të Kosovës, me temën "Njohja me bazat e barazisë gjimore dhe legjislati në fuqi". - ABGJ ka ndriçuar Ndërtesën e Qeverisë me simbolin e fushatës. Janë shtypur materialeve promovuese -senzibilizuese për fushatën kombëtare (ombrellat, tobeg, kordelet e bardha, fletore) ne kuadër të shënimit të 16 Ditëve të Aktivizmit. Buxheti për këto materiale është 3 768.7 euro - ABGJ ne bashkëpunim me ZQM ka realizuar 1500 fletushkave për parandalimin e martesave te hershme të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas. Shuma totale 300 euro - ABGJ ka ndriçuar ndërtesën e Qeverisë me ngjyrë vjollce, simbol i luftës kundër kancerit te gjirit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për kontrole parandaluese. Buxheti për këtë aktivitet është 1587.70 - ABGJ ka shënuar 8 Marsin Dita Ndërkombëtare e Gruas nën sloganin "Bashkë për barazi". Ku u organizua konferencë dhe u diskutua për rolin e grave në proceset dhe agjendat e zhvillimit socio ekonomik të vendit, për një transformim shoqëror të qëndrueshëm dhe te barabartë. Konferencën e ndoqën rreth 75 pjesëmarrës. Buxheti për këtë aktivitet është 1. 338 euro.
--	---	---

Realizimi i videospoteve me fusha tematike të parandalimit të dhunës, eliminimit të stereotipeve, të drejtat pronësore, parandalim te ngacmimit seksual	5 videospote te planifikuara	• ABGJ në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore ka mbajtur takimin e rregullt konsultativ, të shtatin me radhë, të nivelit të lartë me akterë institucionale, ekspertë/e dhe përfaqësues/e nga shoqëria civile. Takimi u mbajt në prag të 30-të vjetorit të Platformës së Pekinit, 24 vjetorit të Rezolutës 1325 Gratë Paqja dhe Siguria,ne këtë takim morën pjesën 86 pjesëmarrës. Buxheti 2.367.60 euro • ABGJ ka realizuar 5 videospote te transmetuar ne RTK dhe ne 3 televizione private. Buxheti për këto videospote dhe transmetimin e tyre është 15. 191.50 euro 1. Dita Ndërkombëtare e gruas" Bashke për barazi" Buxheti" https://www.youtube.com/watch?v=NOo9PSMOCr8&t=8s 2. "Parandalimi i Ngacnimeve Seksual në Rrjetet Sociale" https://www.youtube.com/watch?v=SvHRn4GoY2k 3. "Buxheti i përgjegjshëm gjinor": https://www.youtube.com/watch?v=nquVSIL2Q-A 4. "Roli i Mekanizmeve Koordinues Lokale për Mbrojtjen nga Dhuna ne Familje": https://www.youtube.com/watch?v=zrrtg 5. Parandalimi i gjuhës se urrejtës ndaj grave ne jetën politike dhe publike https://www.youtube.com/watch?v=oiFzNhu3bzv
--	-------------------------------------	--

Financimi i	Te	ABGJ ka financuar 4 OJQ nga kategoria e	
Organizatave te	planifikuara	subvencioneve për fuqizimin e grave me aftësi te	
shoqërisë Civile	4/5 OJQ	kufizuar, gratë nga minoritetet etnike Roma, Ashkali	
në fushën e		dhe Egjiptian, nënave vetushqyese dhe moshat e treta	
barazisë		me vlerën 40.000 euro.	
gjimore,		✓ Shoqatën e të verbërve të Kosovës me	
parandalimit		projektin "Vetëdijësimi i vajzave dhe grave te	
dhe trajtimit të		verbëta për shëndetin dhe kancerin e gjirit".	
dhunës ndaj		✓ General Youth Education of Kosovo GYEK-	
grave dhe		me projektin "Aftësimi i vajzave dhe grave të	
mbrojtjes nga		komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për	
diskriminimi		tregun e punës".	
		✓ OFAP- me projektin "Ngritja e kapaciteteve të	
		nënave vetushqyese për disiplinimi pozitive	
		në prindërimin e përditshëm"	
		✓ Komitetin e grave të verbëta të Kosovës me	
		projektin " Zhvillimi i aftësimeve për qasje ne	
		treg te punës të gratë dhe vajzat e verbra në	
		Kosovë.	
		• ABGJ me synim të përmirësimit të situatës së	
		grave nga kategoritë specifike ka zbatuar	
		masën e ndërmarrë nga <u>Qeveria e RKS</u>	
		<u>Vendimi nr. 04/197</u> , Masa 1.7 Skema e	
		Granteve për Zanate te Pakos se Ringjalljes	
		Ekonomike, duke mbështetur 64 familjare-	
		gra dhe vajza te familjeve përfituese te	
		pensioneve për familjare të zhdukur gjate	
		luftës në Kosovë, me shumën 249,460.00 euro	
		në realizimin e blerjes së pajisjeve për punë	
		sipas specifikave në thirrje-kryesisht pajisje	
		bujqësore.	

Objekti 2	Promovimi i vlerave të Barazisë Gjimore përmes qendrimit të gjinor dhe eliminimit të stereotipeve gjinore në legjislacion, politika publike dhe shoqëri		Niveli i arritjes së zbatimit të cësësive të PKBGJ	- Gjatë vitit ABGJ ka hartuar dhe prezantuar edhe vlerësimin final të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) për periudhën 2020-2024. - ABGJ ka iniciuar hartimin e PKBGJ 2025-2035, dhe planit të veprimit të tretin me radhë. Është themeluar grupi punës me Vendim të Qeverisë, është hartuar dhe prezantuar metodologjia për hartimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2025-2035. Përmes këtij programi, Agjencia synon të hartoj një politikë publike e cila mundëson fuqizimin e rolit dhe përfshirjen e grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës sociale, ekonomike dhe politike, duke siguruar një qasje të barabartë për të gjithë. Janë angazhuar 4 konsulentë. Përmes mbështetjes së asistencës teknike të financuar nga BE dhe të zbatuar përmes projektit GEF-UN WOMEN. - Bazuar në kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore për integrimin gjinor dhe vlerësimin e ndikimit gjinorë ABGJ ka ofruar komente për 1 ligj, 6 projekt ligje, 1 Draft - Program kombëtar dhe 1 strategji, 13 Projekt rregullorë, 2 Koncept dokumente, 5 Projekt Udhëzime Administrative.	Numri i dokumenteve strategjike të komentuar a për				

	Hartimi i Aktit normativ për Buxhetimin e Përgjeshëm gjinor		integrim te perspektiv es gjinore	• Projekt rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për barazi gjinore është dorëzuar për aprovim • ABGJ dhe Ministria e Financave Punës dhe Transfereve kanë themeluar grupin punues për hartimin e kornizës ligjore për Buxhetimin e përgjeshëm gjinor; është hartuar metodologjia e punës dhe paketa informuese për GP. Grupi punues institucional për hartimin e Buxhetimit të Përgjeshëm Gjinor ka realizuar 3 punëtori (7 dite). Grupi Punues është duke u mbështetur me asistencë teknike nga UN WOMEN përmes Programit Rajonal të Ballkanit Perëndimor, financuar nga SIDA. Buxheti i shpenzuar nga ABGJ- 11.660.88 euro. • Ne zbatim te aktiviteteve te dalura nga koncepti dokumenti i Buxhetimit te përgjeshëm gjinor dhe ne zbatimin te objektivit te zhvillim te qëndrueshëm 5C1, ABGJ dhe Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, me mbështetje të UN Women kanë organizuar punëtori dy ditore. Në këtë punëtori morën pjesë Deputet e Kuvendit te Kosovës dhe stafi i Kuvendit të Kosovës. • ABGJ në bashkëpunim me Zyrtaren për Barazi Gjinore në komunën e Fushë Kosovës ka organizuar punëtorinë për Buxhetimin Gjinor. Në këtë punëtori ishin prezent zyrtar nga Komuna e Fushë Kosovës të cilët u njohuan për rëndësinë e BPGJ, për integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha fazat e proceseve buxhetore.	
--	--	--	--	--	--

				• ABGJ, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe UN WOMEN ka bashkë organizuar takimin për 25 zyrtarë të nivelit vendimmarrës nga institucionet publike ku janë hartuar Deklaratat e Buxhetit me perspektivë Gjinore. Ky dokument do të përshkruajë alokimin buxhetore dhe shpenzimet publike që synojnë promovimin e barazisë gjinore. • ABGJ, Ministria e Financave Punës dhe Transferova dhe Ministria e Pushtetit Lokal me mbështetjen e UN WOMEN ka bashkë organizuar punëtori dyditore për 40 zyrtar të 16 Komunave si ZBGJ, drejtorët e financave mbi çështjet integritetit të buxhetimit të përgjigjeshim gjinor në qarkoret buxhetore. • Agjencia për Barazi Gjinore/ZKM në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës/ Fakulteti Ekonomik dhe me mbështetje të Un Women ka mbajtur <i>Konferencën "Mbyllja e hendekut gjinor"</i>. Konferenca ka sjellë bashku studentes/e, politikëbërës/e, aktivistë/e, dhe individë të pasionuar pas barazisë gjinore për t'u angazhuar në dialog, për të ndarë njohuri dhe për të diskutuar praktikatat e mira ndërkombëtare dhe vendore për krijimin e një bote më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë. Buxheti i ABGJ-se 3.727.00 euro.	
	Thellimi i bashkëpunimit me UP				

					• ABGJ së bashku me profesor dhe studentë të Fakultetit Ekonomik kanë mbajtur një tryezë diskutimi për librin i cili është përkthyer në gjuhën shqipe nga një numër i profesorëve me titull <i>‘Hyjje e Avancuar në Ekonomiksin Feminist’</i>, autores Joyce P. Jacobsen. Libri përbën një kontribut të shkëlqyer në informimin e argumentuar dhe shkencor të debatit në shoqëri për rëndësinë e barazisë gjinore, si për individin dhe familjen, ashtu edhe për shoqërinë. Me këtë rast ABGJ ka dhuruar për Bibliotekën e Fakultetit Ekonomik <i>120 kopje të librit ‘Hyjje e Avancuar në Ekonomiksin Feminist’</i>, i autores Joyce P. Jacobsen, i përkthyer në gjuhën shqipe. • ABGJ se bashku me NDI- ka mbajtur shkollën verore mbi Gjinin Ekonominë dhe Politikën. Ku në programin 5 ditor ka bashkuar 28 student dhe lider te rijnë ne një mjedise multietnik nga moshë 18 - 29 vjeçare. Buxheti 606.25 euro	
--	--	--	--	--	--	--

Objektivi					Masa
3 Realizimi i të drejtave pronësore te grave në përmbushje të drejtave themelore dhe përfaqësim në vendimmarrje në administratë publike	Numri i grave në pozita				Afirmative regjistrimit te pronës se paluajtshme e përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve e ka gene në fuqi deri ne prill të vitit 2024. Për shkak të hartimit të udhëzimit të ri Udhëzimi administrativ për tarifat shërbimet kadastrale gjeodezike dhe regjistrim te pronave" që hyri në fuqi gjatë vitit 2024, prezantimi i masës afirmative është shtyrë për fillim të 2025.

